

Transporti ndërkombëtar dhe shërbimet e lidhura me të

Në zbatim të Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, trajtohen si furnizime me shkallë zero të TVSH-së, transaksionet e mëposhtme të transportit ndërkombëtar:

- a) furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme, për lundrimin në det të hapur të:
 - i) anijeve për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve me pagesë ose;
 - ii) anijeve për ushtrimin e veprimtarive tregtare, industriale e të peshkimit;
 - iii) anijeve për kryerjen e veprimeve të shpëtimit dhe ndihmës në det
 - iv) anijeve për peshkimin bregdetar, përveç furnizimit me rezerva të tjera të nevojshme;
- b) furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme të anijeve luftarake të përfshira në kodin e Nomenklaturës së Kombinuar (NC) 8906 10 00;
- c) furnizimi i shërbimeve të lidhura me anijet;
- d) furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme të mjeteve fluturuese, që përdoren nga kompanitë e transportit ajror për transport ndërkombëtar me pagesë;
- e) furnizimi i shërbimeve të kryera për mjetet fluturuese, që përdoren nga kompanitë e transportit ajror për transport ndërkombëtar me pagesë.

Shërbime të lidhura drejtpërdrejtë me mjetet për transport ndërkombëtar detar dhe ajror

Për mjetet detare

Trajtohen si furnizime me zero % të TVSH-së, furnizimet e mëposhtme të kryera për anijet që janë të licencuara për aktivitetin e tyre ndërkombëtar sipas legjislacionit shqiptar apo të huaj të fushës:

- Anijet e përdorura për një veprimtari industriale në det të hapur dhe për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve me pagesë;
- Anijet e posaçme të licencuara për peshkimin profesional, vetëm kur peshkojnë në ujëra ndërkombëtare;
- Anijet e shpëtimit dhe të asistencës në det, përfshirë anijet e pilotimit dhe ormexhimit.

Dokumentacioni justifikues

Personi i tatueshëm që kryen furnizimet sa më sipër, duhet të dokumentojë dhe të zotërojë të gjithë dokumentacionin e duhur sipas legjislacionit të fushës, që të vërtetojë kryerjen e

furnizimit për mjetet si më sipër. Për këtë, ai duhet të pajiset edhe me një vërtetim/ deklaratë noteriale të lëshuar nga blerësi (zotëruesi i anijes), për çdo shërbim të kryer që dëshmon se anija që furnizohet, kryen aktivitetin ndërkombëtar sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen të ligjit.

Përjashtimet

Nuk përfshihen ne trajtimin si më sipër, veçanërisht anijet që nuk janë pjesë e këtyre kategorive. I tillë është rasti i:

- anijeve të përdorura për një veprimtari industriale brenda ujërave territoriale;
- anijeve të kultivuesve të midhjeve, kultivuesve të stridheve, kultivuesve të butakëve;
- anijeve për qëllime sportive ose për argëtim;
- anijeve të Flotës Kombëtare.

Kujdes!

Përsa sqarohet në këtë pikë, shërbimet e kryera për këto mjete nuk konsiderohen si shërbime në funksion të transportit ndërkombëtar dhe janë të tatueshme me shkallën tatimore 20%.

Për mjetet ajrore

Shërbime të kryera për mjete ajrore dhe ngarkesën e tyre

Konsiderohen si shërbime të kryera për nevoja të drejtpërdrejta të mjeteve fluturuese ose ngarkesës së tyre dhe trajtohen me shkallë zero të TVSH-së, furnizimet e shërbimeve të mjeteve fluturuese që përdoren nga kompanitë e transportit ajror për transport ndërkombëtar me pagesë.

Personi i tatueshëm që kryen furnizimet sa më sipër duhet të dokumentojë dhe të zotërojë të gjithë dokumentacionin e duhur sipas legjislacionit të fushës, që të vërtetojë kryerjen e furnizimit për mjetet fluturuese për transport ndërkombëtar dhe për nevoja të tyre.

Përjashtime

Nuk janë furnizime shërbimi me 0%, shërbimet e kryera për:

- mjetet fluturuese të përdorura për kompanitë ajrore, të cilat nuk i plotësojnë kushtet e transportit ndërkombëtar, referuar legjislacionit të fushës;
- avionët, mjetet fluturuese për turizëm apo për përdorim privat.